



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 569/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Sori-AL” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt *LOTI I: “Shërbim gjelbërimi për Spitalin Universitar të Traumës”*, me nr. REF-64023-04-19-2018, me fond limit 7,159,944 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara).

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Kajmaku” sh.p.k, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Sori-AL” sh.p.k
Adresa: Rr. “Beqir Luga”, Pallati nr.3, Shk.1/1, Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Ministria e Brendshme (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara)
Adresa: Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 20.04.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt *LOTI I: “Shërbim gjelbërimi për Spitalin Universitar të Traumës”*, me nr. *REF-64023-04-19-2018*, me fond limit 7,159,944 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.05.2018, nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara).

II.2 Në datën 21.05.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 05.06.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|----------------------|--------------------------|---------------|
| 1. “Kajmaku” sh.p.k, | 6,103,944 lekë pa tvsh | Kualifikuar; |
| 2. “Sori-Al” sh.p.k. | 7,013,020.8 lekë pa tvsh | Skualifikuar; |

II.4. Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik “Sori-Al” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyen si më poshtë vijon:

“Nuk arriti të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007 sipas konformitetit me standartet europiane, sepse certifikata e paraqitur N.22486 nuk përmban si aktivitet “kujdesin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra” apo aktivitet të ngjashëm me të. Certifikata e paraqitur nga ana e ofertuesit përmban si fushë aktiviteti: “Përgatitja, shërbimi dhe dhënia e vakteve; Shërbime pastrimi dhe saniteti”. Sqarojmë se në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018 si dhe nenit 30 VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se cdo certifikatë duhet të jetë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit. Prandaj ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gërmën “c” të seksionit 2.4 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikim të DST”

II.5. Në datën 12.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Sori-Al” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke kërkuar skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kajmaku” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 587/1 Prot. datë 18.06.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Sori-Al” sh.p.k., duke mospranuar pretendimet e ngritura në ankesë.

II.7. Në datën 25.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Sori-Al” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Argumentimi i shoqërisë mbi ankimimin:

Së pari. Norma OHSAS 18001:2007, ndryshe referuar si Certifikimi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë është një normë ndërkombëtare e cila i referohet identifikimit të kuadrit ligjor të ka për qëllim njohjen kontrollin dhe zvogëlimin e rreziqeve

të lidhen me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Kjo normë është strukturuar në një mënyrë që, organizmi që e aplikon atë, pavarësisht objektivit të veprimtarisë së tij, të rishikojë dhe të përmirësojë vazhdimisht proceset e sigurisë dhe shëndetit në punë, të informohet në çdo kohë mbi ndryshimet në legjislacionin në fuqi mbi sigurinë dhe shëndetin në punë. ISO OHSAS 18001:2007 kërkon gjithashtu që punonjësit të njihen me legjislacionin në fuqi mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, kërkon që një pjesë e punonjësve të përfshihen në identifikimin e risqeve në punë dhe përcaktimin e mjeteve për kontrollin e tyre. Nëpërmjet implementimit të kësaj norme, synohet që organizata të ndryshme të menaxhojnë rreziqet që lindin në punë, të reduktojnë aksidentet në punë, të përmirësojnë performancën e tyre, të garantojnë sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe të veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Se dyti. KVO-jë në argumentimin e saj mbi refuzimin e ofertës së shoqërisë tonë është shprehur se "...çertifikata e paraqitur Nr. 22486 nuk përmban si aktivitet "kujdesin dhe mirëmbajtjen e hapsirave të gjelbra apo aktivitet të ngjashëm, me të. " Sqarojmë se në DST-në e publikuar nga Autoriteti Kontraktor, Shtojca 8, Loti I, pjesa Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.4 "Liçencat Profesionale", germa "c", është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesi një "certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007 sipas konformitetit me standartet europiane". dhe që "Certifikata të jetë e lëshuar nga në organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", kriter i cili është përmbushur nga Shoqëria "SORI-AL" Sh.p.k. Në DST-në e publikuar nga Autoriteti Kontraktor, është kërkuar në mënyrë eksplicite që operatori ekonomik të vërtetojë përmes ekstraktit të regjistrit tregtar ose historik se ka objekt veprimtarie në fushën e shërbimit të gjelbërimit dhe të paraqesë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit. Në këto 2 kritere njësia e hartimit të DST-së ka kërkuar Operatorëve të vërtetojnë përfshirjen e shërbimit të gjelbërimit.

Së treti. Certifikimi me ISO 18001:2007 lidhet ngushtë me certifikimin me ISO 9001 dhe ISO 14001 për arsye se këto tre norma të menaxhimit të standarteve dhe sistemit, sigurojnë për aftësitë e një organizmi për të garantuar cilësinë në shërbim, për të plotësuar kërkesat mjedisore dhe për të garantuar një ambient të sigurisë dhe shëndetit në punë. Këto sisteme menaxhimi identifikohen si IMS (Integrated Management System), sisteme menaxhimi të integruara të cilat janë të lidhura ngushtë dhe egzistojnë më mënyrë kumulative me njëra tjetrën. Lidhja midis këtyre sistemeve shihet në sektorin e aplikimit të normës përkatëse bazuar në Marrëveshjet e Njohjes Reciproke IAF dhe EA në të cilat sektori 30 dhe 35 është i përbashkët për të treja normat dhe që i referohen: Sektori 30 Hotele dhe restorante dhe Sektori 35 Shërbime të tjera. Sistemi i Menaxhimit të Integruar është i rëndësishëm për çdo organizim, pavarësisht nga tregu ku veprojnë dhe nga objekti i veprimtarisë. Integrimi i disa sistemeve të menaxhimit në një sistem të unifikuar siguron një koherencë të përgjithshme të të gjithë veprimtarisë së organizmit. Ky sistem integron të gjitha sistemet e cilësisë, mjedisit dhe sigurisë dhe shëndetit në punë në një kuadër të plotë, duke bërë të mundur që një organizatë të funksionojë si një njësi e vetme me objektiva të unifikuar.

Së katërti. Rekomandimi i APP-së dhe DPA-së hyrë në fuqi nga data 20.03.2018, orienton Autoritetet Kontraktore, që të mbajnë në konsideratë rekomandimet e parashikuara gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim prandaj nga ana e Autoritetit Kontraktor që në përcaktimin e kriterëve në DST duhet të shprehet qartë përmbajtja e kërkesave të veçanta për kualifikim.

Ndërsa, në lidhje me kualifikimin e shoqërisë “KAJMAKU” Sh.p.k, pretendojmë se është i parregullt duke Ju argumentuar si më poshtë vijon:

1. Operatori Ekonomik “Kajmaku” Sh.p.k nuk përmbush pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8 “Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 viteve të fundit shërbime të ngjashme me një vlerë jo më pak se 40 % e fondit limit”, pasi kontratat e dorëzuara nga Operatori ekonomik përfshijnë disa lloje shërbimesh dhe në vërtetimet e realizimit nuk saktësohet vlera e realizuar e kontratës së ngjashme për shërbimin e gjelbërimit.

2.Operatori Ekonomik “KAJMAKU” Sh.p.k nuk përmbush pikën 2.4 “Liçencat Profesionale”, të shtojcës 8, pasi certifikatat e dorëzuara prej tij ISO 9001-2008/ISO 9001:2015; ISO 18001:2007; ISO 14001:2004/ ISO 14001:2015; nuk janë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

3.Operatori Ekonomik “KAJMAKU” Sh.p.k nuk përmbush pikën 2.5 “Kërkesat profesionale të personelit kryesor”, të shtojcës 8, pasi nuk ka dorëzuar asnjë librezë shëndetsore për personelin e kërkuar sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Sqarojmë se librezat e kontributeve të sigurimeve shoërore nuk është e barazvlefshme me librezën shëndetsore.

4. Operatori Ekonomik nuk plotëson kriteret teknike edhe në lidhje me mjetet dhe pajisjet, konkretisht mjete i dorëzuar si “vinc me kosh për krasitjen e pemëve në lartësi” nëse i referohemi certifikatës së pronësisë së mjetit gjenden të dhënat se nuk ka atë destinacion, pra nuk është mjet që përdoret për krasitjen e pemëve. I njëjti argument vlen edhe për autobotin (makinë larëse).

5. Operatori nuk ka dorëzuar deklaratë ku të specifikojë mjetet që do të angazhohen në këtë procedurë prokurimi si dhe kontratat e qerasë për mjetet nuk përmbajnë objektin e procedurës. [...]”

II.8.Në datën 12.07.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.666/1prot., datë 06.07.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sori-AI” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : *“Nuk arriti të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007 sipas konformitetit me standartet europiane, sepse certifikata e paraqitur N.22486 nuk përmban si aktivitet “kujdesin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra” apo aktivitet të ngjashëm me të. Certifikata e paraqitur nga ana e ofertuesit përmban si fushë aktiviteti: “Përgatitja, shërbimi dhe dhënia e vakteve; Shërbime pastrimi dhe saniteti”. Sqarojmë se në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018 si dhe nenit 30 VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se cdo certifikatë duhet të jetë e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit. Prandaj ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gërmën “c” të seksionit 2.4 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikim të DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1.Në shtojcën 8, pika 2.4, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“a.Çertifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise ISO 9001:2008/9001:2015 sipas konformitetit me standartet europiane.

b.Çertifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te ambientit ISO 14001:2004/14001:2015 sipas konformitetit me standartet europiane.

c.Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 18001:2007 sipas konformitetit me standartet europiane.

Çertifikata të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.”

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “Sori-AI” sh.p.k., ka dorëzuar:

- Certifikatë UNI EN ISO 9001:2015 me nr.11927, lëshuar nga organizimi certifikues Certiquality s.r.l, për operatorin ekonomik “Sori-AI”, sh.p.k. në gjuhën italiane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.
- Certifikatë UNI EN ISO 14001:2004 me nr.22485, lëshuar nga organizimi certifikues Certiquality s.r.l, për operatorin ekonomik “Sori-AI”, sh.p.k. në gjuhën italiane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

- Certifikatë OHSAS 18001:2007 me nr.22486, lëshuar nga organizimi certifikues Certiquality s.r.l, për operatorin ekonomik “Sori-Al”, sh.p.k. në gjuhën italiane dhe të përkthyer në gjuhën shqipe

III.1.4.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.5.Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6.Në nenin 30 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet: *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

1.Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001:2008/9001:2015; ISO 14001:2004/14001:2015; ISO 18001:2007. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimues “Sori-Al” sh.p.k., ndër të tjera, për të vërtetuar se kryen aktivitetin e tij sipas standarteve për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë,

ka paraqitur certifikatën OHSAS 18001:2007 me nr.22486, lëshuar nga organizimi certifikues Certiquality s.r.l.

Nga shqyrtimi i kësaj certifikate, rezulton se operatori ekonomik ankimues është certifikuar për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas standartit OHSAS 18001:2007 për aktivitetet “Përgatitja, shpërndarja dhe dhënia e vakteve” dhe “Shërbime pastrimi dhe saniteti”. Në këto kushte, Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk arrin të vërtetojë se kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standartit 18001:2007, pasi me anë të certifikatës të sipërcituar, ankimuesi vërteton se është i certifikuar për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas standartit OHSAS 18001:2007 vetëm për dy shërbimet e sipërcituara, të cilat referuar kodeve EA sipas dokumentit udhëzues të Organizmit European të Akreditimit, që bazohen në aneksin 1, të rishikimit 2, të “NACE-National Classifications of Economic Activities” (Klasifikimi Kombëtar i Aktiviteteve Ekonomike), miratuar në Rregulloren (EC) të Parlamentit European nr.1893/2006, janë aktivitete totalisht të ndryshme dhe me kode EA të vecanta.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “[...]Lidhja midis këtyre sistemeve shihet në sektorin e aplikimit të normës përkatëse bazuar në Marrëshjet e Njohjes Reciproke IAF dhe EA në të cilat sektori 30 dhe 35 është i përbashkët për të treja normat dhe që i referohen: Sektori 30 Hotele dhe restorante dhe Sektori 35 Shërbime të tjera. Sistemi i Menaxhimit të Integruar është i rëndësishëm për çdo organizim, pavarësisht nga tregu ku veprojnë dhe nga objekti i veprimtarisë. Integrimi i disa sistemeve të menaxhimit në një sistem të unifikuar siguron një koherencë të përgjithshme të të gjithë veprimtarisë së organizmit. Ky sistem integron të gjitha sistemet e cilësisë, mjedisit dhe sigurisë dhe shëndetit në punë në një kuadër të plotë, duke bërë të mundur që një organizatë të funksionojë si një njësi e vetme me objektiva të unifikuar [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se, në dokumentin udhëzues të Organizmit European të Akreditimit, kodi EA 30 “Hotele dhe restorante” që përfshin aktivitetet e parashikuara sipas kodeve të NACE 55 (Hotele dhe akomodime të ngjashme) dhe 56 (Shërbime ushqimi dhe pijesh) nuk e përfshin në asnjë rast aktivitetin e shërbimit objekt prokurimi, ndërsa kodi EA 35 “Shërbime të tjera” përfshin aktivitetet e parashikuara sipas kodeve të NACE 69, 70, 73, 74.3, 78, 80, 81, 82, që i përkasin aktiviteteve duke filluar nga shërbime ligjore, kontabiliteti, marketing etj., e deri të shërbimet e përkthimit, sigurisë private, pastrime, si dhe mirëmbajtje të ambienteve të gjelbëra. Citimi i kodit EA 35 apo IAF 35 në certifikatë nga organizmi certifikues është thjesht referues, e për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si certifikim në të gjitha aktivitetet e përfshira në këtë kod, pasi do të ishte e pamundur. Në këto kushte, nisur nga gama shumë e gjerë dhe e larmishme që përfshin kodi EA 35, referuar në udhëzimet dhe manualet e organizmave të akreditimit si EA dhe IAF, Komisioni gjykon se në certifikatën e lëshuar për subjektin duhet specifikuar domosdoshmërisht aktiviteti konkret për të cilin subjekti përmbush standartin, pasi për certifikimin e një subjekti me një apo më shumë standarte, organizmat certifikuese janë të detyruara të kryejnë auditimet përkatëse të cilat janë specifike sipas fushës së veprimtarisë. Vlen të theksohet, se ky fakt vërtetohet edhe në certifikatat UNI EN ISO 9001:2015 me nr.11927 dhe UNI EN ISO 14001:2004 me nr.22485, të cilat janë lëshuar nga i njëjti organizëm certifikues dhe citojnë në mënyrë të

vecantë aktivitetin objekt prokurimi *“Kujdesi dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëra”*. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues *“Sori-Al”* sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8, pika 2.4, *“Kapaciteti teknik”*, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi nuk vërtetohet se është i certifikuar për cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas standartit 18001 për shërbimin objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Sori-Al”* sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik *“Kajmaku”* sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.2.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.2.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sori-AI” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt *LOTI I: “Shërbim gjelbërimi për Spitalin Universitar të Traumës”*, me nr. *REF-64023-04-19-2018*, me fond limit *7,159,944* lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën *21.05.2018*, nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme (Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara).
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1184 protokoli Datë 25.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

